



THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE PËR VËZHGIMIN DHE MONITORIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË KONSUMATORIT SI DHE INFRASTRUKTURËN E CILËSISË NË MINISTRINË E TREGTISË DHE INDUSTRIË

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është duke kërkuar përfaqësues të shoqërisë civile si pjesë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të MTI-së dhe Platformës CiviKos për vëzhgimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit si dhe infrastrukturën e cilësisë në MTI. Sekretariati i CiviKos do të lehtësoj procedurat e përzgjedhjes sipas Rregullores së Punës të CiviKos.

Përfaqësuesit e përzgjedhur të Shoqërisë Civile do të angazhohen në këto aktivitete të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI)*:

1. Do të jenë pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procedurat e tenderimit, përfshirë procesin e hapjes, vlerësimit, vendimit si dhe menaxhimit të Kontratave duke ju siguruar qasje të plotë dhe të drejtpërdrejtë në të gjithë dokumentacionin e tenderit, për aq sa lejojnë dispozitat ligjore në fuqi.
2. Do të jenë pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procedura e zbatimit të legjislacionit lidhur me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit si dhe legjislacionit lidhur me infrastrukturën e cilësisë.

Me këtë rast kërkohen përfaqësues të shoqërisë civile në këto fusha†:

Prokurim

- 1 përfaqësues për Monitorimin e procedurave të prokurimit dhe tenderimit,
- 1 përfaqësues për Monitorimin e zbatimit të kontratave.

Mbrojtja e Konsumatorit –

- 1 përfaqësues për Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e Konsumatorit,
- 1 përfaqësues për Shqyrtimin e ankesave,
- 1 përfaqësues për Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes së konsumatorit

* Aktivitetet specifike do të diskutohen dhe dakordohen me përfaqësuesit e përzgjedhur

† Në letrën motivuese kandidatët e nominuar duhet të specifikojnë maksimum tri fusha ku dëshirojnë të nominohen

Mbikëqyrja e Tregut –

- 1 përfaqësues për Monitorimin e inspektimeve të tregut,
- 1 përfaqësues për Monitorimin e procesimit të lëndëve që trajtohen nga gjykatat.

Infrastruktura e Cilësisë –

- 1 përfaqësues për Hartimin e akteve legislative,
- 1 përfaqësues për monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Mënyrën e Autorizimit të TVK-ve,
- 1 përfaqësues për Monitorimin e shërbimeve Metrologjike,
- 1 Përfaqësues për Promovimin e rëndësisë së infrastrukturës së cilësisë

Kriteret për organizata që nominojnë përfaqësuesit e tyre:

Të drejtën për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OShC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ si dhe rrjetet e OShC-ve (pavarësisht regjistrimit të tyre), të cilat:

1. Janë aktive për të paktën 3 vite;
2. Organizata të ketë mision së paku njërin nga këto fusha: transparenca dhe llogaridhënia, fusha e prokurimit, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit, mbikqyrja e tregut dhe infrastruktura e cilësisë.

Ftesa nuk është e kufizuar vetëm te organizatat anëtare të Platformës CiviKos

Kriteret për personat që nominohen:

1. Të kenë përvojë të dëshmuar në fushën përkatëse për të paktën 3 vite;
2. Të jenë të angazhuar në një organizatë të shoqërisë civile e cila për të paktën 3 vite të fundit ka fushë të veçantë të veprimtarisë fushën përkatëse (transparenca dhe llogaridhënia, fusha e prokurimit, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit, mbikqyrja e tregut dhe infrastruktura e cilësisë).
3. Të kenë njohuri për kauzën, për të drejtat e obligimet dhe për intereset e dinjitetin e qytetarit konsumator.

Për të nominuar një kandidat/e, OSHCja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Një cv të kandidatit/es së nominuar
2. Letër motivimi (max. 1 faqe) si dëshmi për përvojën e tyre në OSHC dhe përvojën e kandidatit në fushën e transparencën dhe llogaridhënien, fushën e prokurimit, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, mbikqyrjen e tregut dhe infrastrukturën e cilësisë (të specifikohen maksimum tri fusha ku kandidati do të dëshironte të mirrte pjesë)

3. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së ose një dokument që dëshmon aktivitetin e rrjetit jo-formal.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email: info@civikos.net, ose në zyrën e Platformës CiviKos Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 02.05.2017 ora 16:00

Mandati i përfaqësuesve të shoqërisë civile

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të përzgjedhur për vëzhgimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit si dhe infrastrukturën e cilësisë në MTI zgjedhen në mandat 1 vjeçar.

Para këtij afati, mandati ndërpritet në rastet e mëposhtme:

1. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile jep dorëheqje;
2. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile largohet nga sektori i shoqërisë civile;
3. Kur të paktën 51% të organizatave të cilat kanë marrë pjesë në procesin e votimit kërkojnë nga Platforma CiviKos që të nisë procedurën e shkarkimit, për shkak të neglizhencës apo mos-përfaqësimit të duhur të interesave të shoqërisë civile.

Në rast të procedurave të votimit

Në rast se kemi më shumë se 1 kandidat që i plotësojnë kriteret atëherë do të shkohet me procedura të votimit, sipas Rregullores së Punës të CiviKos. Kandidati që merr më së shumti vota do të përzgjidhet si përfaqësues i Shoqërisë Civile për vëzhgimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit si dhe infrastrukturën e cilësisë në MTI.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i MTI-së do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Votuesit mund të votojnë në mënyrë anonime me hedhjen e votës së tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos-it. Në cilëndo mënyrë të votimit, fletëvotimit duhet t'i bashkëngjitet edhe kopja e certifikatës së regjistrimit të organizatës.



Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos. Pas zgjedhjeve, Komisioni shqyrton dhe numëron fletëvotimet dhe përcakton se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShc-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i femrave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.